




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Priljen/Prodato Received/Delivery	14.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	8056/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.965/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.965/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit me Nr. 01-143/22 të datës 03.10.2022 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Ferizajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.965/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 31.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 6587/2022, kundër Vendimit me Nr. 01-143/22 të datës 03.10.2022 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Ferizajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.11.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Ferizajt. Ndërsa Këshilli, me datë 08.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6587/2022 të datës 31.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01-143/22 të datës 03.10.2022 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Ferizajt; Certifikatën trajnimi e datës 04.04.2019; Dilomën me Nr. 6105 e datës 12.03.2019; Ankesën e datës 28.09.2022 e ankuesit pran Komisionit të Pranimit dhe Zyrës së Personelit; Emailin e datës 30.10.2022 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 6692/2022 e datës 03.11.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 6882/2022 e datës 08.11.2022; Konkursin me numër reference: RN00009496 i datës 18.07.2022 për Specialit të Administrimit të Përgjithshëm; Vendimin me numër 091 Nr.01-75/22 i datës 19.08.2022 për themelimin e komisionit të pranimit; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për aplikim e datës 31.08.2022; Lista përfundimtare e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për aplikim e datës 05.09.2022; Njoftimin e datës 21.09.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Formulari për vlerësimin individuale të biografisë së kandidatit (ankuesit) e datës 19.09.2022; Vendimin me Nr. 01-89/22 i datës 26.08.2022 për refuzim të aplikacionit të ankuesit; Vërtetimin e datës 19.08.2022, 01.09.2022; Vendimin me Nr. 01-107/22 i datës 05.09.2022 për aprovim të ankesës së ankuesit; Aplikacionin e ankuesit i datës 22.08.2022; Certifikatën nga Gjykata Themelore në Ferizaj e datës 15.08.2022; Certifikatën C.ND.701/22 të datës 15.08.2022; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Lista e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 03.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit me numër A.nr.965/2022 të datës 31.10.2022, *sepse:*

Në bazë të administrimit të provave materiale Kolegji ka gjetur se Komuna e Ferizajt më datë 18.07.2022 ka shpallur Konkursin e pranimit me numër reference RN00009496 për grupin e pozitive "Specialit të Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën Asistent Administrativ, Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme dhe Zyrtar i Gjendjes Civile 4, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, të njëjtit me Vendimin me Nr.01-89/222 të datës 26.08.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin së ankuesi nuk ka plotësuar kriteret e konkursit. Me tej, ankuesi ka parashtruar ankesë kundër Vendimit me Nr.01-89/222 të datës 26.08.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, ndërsa ky i fundit me Vendim me Nr.01-107/22 të datës 05.09.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe të njëjtin e ka përfshirë në listën e ngushtë. Sipas shkresave të lëndës ankuesi i është nënshtruar vetëm testit me shkrim dhe vlerësimit të jetëshkrimit ku bazuar në Listën përfundimtare të kandidateve të datës 03.10.2022 ankuesi është vlerësuar me 50 pikë në testin me shkrim dhe 8 pikë në jetëshkrim gjithsej 58 pikë. I pakënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit, ankuesi parashtron ankesë pranë Komisionit të Vlerësimit, i cili me Vendimin e atakuar ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin së vlerësimi i jetëshkrimit është bërë në pajtim me nenin 22 të Rregullores (QRK0 Nr.16/202 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.01-143/22 të datës 03.10.2022 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Ferizajt, pretendon se procedura e pranimit me numër reference RN00009496, është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin civil.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me këtë proces të pranimit ka vendosur sipas ankesës së kandidatës [redacted] ku me Vendimin A.nr.908/2022 të datës 09.12.2022 ka shfuqizuar Njoftimin me numër 01-138/22 të datës 27.09.2022 të Zyrës së Personelit, si dhe Listën përfundimtare të kandidatëve të datës 03.10.2022 të Komisionit të Vlerësimit, fazën e vlerësimit përfshirë testimin me shkrim, jetëshkrimin dhe intervistën me gojë, duke udhëzuar organin e punësimit që procedura e rekrutimit me numër referencë RN00009496 të vazhdoj nga faza e verifikimit paraprak.

Andaj, bazuar në gjendjen faktike si me lartë, dhe duke marrë parasysh së objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.965/2022 ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr. 908/2022 të datës 09.12.2022, respektivisht ka anuluar në tërësi fazan e vlerësimit (testin me shkrim, jetëshkrimin, intervistën me gojë dhe vlerësimin përfundimtar) Kolegji i Këshillit konstaton së objekti i ankesës A.nr.965/2022 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.965/2022 të datës 31.10.2022.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.965/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së;